

URDHËR
Nr.177/1, datë 16.3.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES NË ZONAT URBANE
(ndryshuar me urdhërin nr.177/2, datë 18.3.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane, vetëm në fashat orare 06-10:00 dhe 16:00-18:00 dhe të pashoqëruar me personat të tjerë në krah.

1/1 Përrjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 bëjnë personat e pajisur me autorizim nga organet kompetente dhe rastet e një emergjence shëndetësore apo shoqëruesit për të sëmurët që marrin shërbim në spital.

2. Ndalimin e lëvizjes së këmbësorëve pensionist në zonat urbane deri në një urdhër të dytë me përrjashtim të rasteve kur kanë një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu